REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 138/17
Datë/Datum. 04.07.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 138/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçrizi- Kryetar z. Tefik Sylejmani -Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "PBC"Sh.p.k-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete"** me nr. prok. KRU 2017/001/236/, iniciuar nga AK-/KRU Hidromorava SH.A – Gjilan/ më datën 19 qershor 2017 mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "PBC"Sh.p.k- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete" me nr. prok. KRU 2017/001/236/, iniciuar nga AK-/KRU Hidromorava SH.A –Gjilan/

II. Autorizohet, AK-KRU Hidromorava SH.A –Gjilan/që të vazhdoj me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete" me nr. prok. KRU 2017/001/236/,

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "PBC"Sh.p.k-Prishtinë, aprovohet si e pjesërisht bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues– KRU Hidromorava SH.A –Gjilan, më dt. 14.02.2017, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete"** me nr. të prokurimit: KRU 2017/001/236.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulet.

Operatori ekonomik ankues "PBC"Sh.p.k-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 12 Maj 2017 me nr. 138/17 kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete" me nr. prok. KRU 2017/001/236/, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues AK-/KRU Hidromorava SH.A –Gjilan/ duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje

neni 7 paragrafi 2, nenit 28 paragrafi 2, nenit 108/A dhe nenit 108/Atë LPP-së, si dhe nenit 18.4 . Udhëzuesit Rregullave për Prokurim Publik..

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 08 mars 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 16.05.2017, duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si pjesërisht të BAZUAR ankesën (vetëm në pretendimin ankimor lidhur me nenin 108/A.2 të LPP-së), OE "PBC" sh.p.k, me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të lejohet Autoriteti kontraktues KRU Hidromorava sh.a, të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit: "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete", me nr. prokurimi: 2017/001/236, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 29.05.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datë: 26.05.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.15.2016,të mbajtur pa pranin e palëve konform nenit 26 paragrafi 1 të rregullores së punës së OSHP-së kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë ekspert shqyrtues ka deklaruar; sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues lidhur me kriteret e vëna në dosje të tenderit, gjegjësisht kriterit "Hostimi i platformës GPS të bëhet vetëm në shtetet e BE-së", ky kriter është eliminuar nga ana e AK-së konform vendimit të panelit shqyrtues nr. 55/17 të datës 27.04.2017.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me shkelje të nenit 108/A, sipas shkresave të lëndës AK nuk ka vepruar konform dispozitave të LPP-së dhe nuk ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit me rastin e pranimit të ankesës. Bazuar ne të cekurat më lart, i rekomandoj panelit shqyrtues që të aprovoj pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues, ndërsa të autorizohet AK që të vazhdoj me procedura të mëtutjeshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtuese deklaroj; qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 24.05.2017.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 7 dhe 28 të LPP-së, paneli shqyrtues sqaron se nuk qëndron për arsye se autoriteti kontraktues në harmoni me vendimin e panelit shqyrtues Nr. 55/17, të dt. 27.04.2017, ka eliminuar kriteret diskriminuese të dosjes së tenderit në lidhje me specifikimin teknik sa i përket kriterit "Hostimi i plantëformes në GPS të bëhet vetëm në shtete e BE", ndërsa kriteret tjera në lidhje me specifikim teknik kanë qenë konform nenit 7 dhe 28 të LPP-së.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 108/A paragrafi 2 të LPP-së, paneli shqyrtues gjatë shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, sqaron se nuk ka hasur në ndonjë shkresë që dokumenton se është pezulluar aktiviteti i prokurimit dhe me këtë pezullim është njoftuar operatori ekonomik ankues, ashtu siç parashihet ne nenin 108/A paragrafi 2 ku thuhet: "*Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar*".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, konstatimeve të cekura në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, parashtresës së autoritetit kontraktues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues, deklaratës së eksperti shqyrtues dhënë gjatë seancës dëgjimore, konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e hartimi të specifikimeve teknike në aktivitetin e prokurimit **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete"** me nr. të prokurimit: KRU 2017/001/236, ka respektuar nenin 7 dhe nenin 28 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -/KRU Hidromorava SH.A –Gjilan/

1x1 OE "PBC"Sh.p.k-Prishtinë,

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.